



BULETINI I OEMVP

**JANAR – MARS
2026**



Str. Dimitrie Cupovski 13
1000 Skopje, Macedonia
Tel. +389 (0)2 3239 252
oemvp.org

www.oemvp.org

Përmbajtja

Përmbajtja	1
Hyrje	3
1. SUNDIM I LIGJIT, INSTITUCIONE EFEKTIVE ME PËRGJEGJËSI FISKALE DHE FINANCIARE SI NEVOJË THELBËSORE PËR EKONOMI TË FUQISHME TË TREGUT TË LIRË	4
1.1 Zhvillimi ekonomik dhe klima e biznesit në fokus të takimit mes OEMVP dhe zv. Kryeministrit të parë Bekim Sali	4
1.2 Realizohet takim me Ministrin e Punëve të Brendshme të RMV. “Safe City” në fokus, OEMVP dorëzon kërkesa për mbrojtjen e aktivitetit afarist	4
1.3 Kryesia e OEMVP realizon takim me drejtoreshën e DAP. Në diskutim çështje me rëndësi për anëtarësinë e Odës	5
1.4 OEMVP realizon takim me Kryetarin e Kuvendit të RMV-së. Diskutimi u fokusua në Propozimin për ndryshimin e Ligjit për përmbardim	5
1.5 OEMVP propozon ndryshime në Ligjin për Përmbardim, në fokus mbrojtja e biznesit, transparenca dhe llogaridhënia	6
Informatori ligjor Juris dhe Juris Alarm	6
2. FUQI PUNËTORE TË MJAFTUESHME DHE TË KUALIFIKUAR ME NJË EKONOMI DIVERZE DHE ZHVILLIMORE QË PARANDALON EMIGRIMIN	7
2.1 OEMVP në takim me Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup. Diskutime mbi fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar	7
3. Shtet vropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtitshme të energjisë.....	8
3.1 U realizua punëtori në OEMVP për pagesat në euro përmes SEPA	8
3.2 Kryesia e OEMVP realizon takim me Ministrin e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Diskutim mbi politikat mjedisore	8
3.3 OEMVP merr pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes për skemën e granteve për bizneset e gjelbra-Tranzicioni i gjelbër, prioritet për zhvillimin e kompanive	9
3.4 Kryesia dhe anëtarësia e OEMVP pjesëmarrëse në ngjarje për mbështetjen dhe fuqizimin e ndërmarrjeve sociale	9
Informatori ekonomik ECONOMICUS.....	10
Biznes Informatori DOBIA	10
4. ODË ME KREDIBILITET DHE PËRFSHIRJE LOKALE DHE RAJONALE, LIDERE NË MBROJTJE TË INTERESAVE AFARISTE	11
4.1 OEMVP zhvillon takim zyrtar me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme për bashkëpunim në funksion të rritjes ekonomike.....	11

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

4.2 Drejtori ekzekutiv i OEMVP, Durim Zeqiri panelist në prezantimin e Strategjisë për NVM-të 2025-2030	11
4.3 OEMVP priti në takim Ambasadorin e Zvicrës në RMV, z. Kristof Zomer. U diskutua thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve	12
4.4 OEMVP realizon mbledhjen e IV-të të Këshillit Mbikëqyrës. Diskutohen raportet dhe çështje mbi funksionimin e Odës	12
4.5 OEMVP nderohet me Mirënjohje për kontributin 15 vjeçar nga Fondacioni Albiz.....	13
4.6 OEMVP bashkon institucionet dhe biznesin në Sofrën Tradicionale të Iftarit, në frymën e partneritetit dhe unitetit shoqëror	13
4.7 OEMVP realizon mbledhjen e I-rë të Këshillit Drejtues për vitin 2026	14
4.8 OEMVP pjesë e forumit ndërkombëtar për promovimin e investimeve në Budapest.....	14
5. ZVOGËLIMI I EKONOMISË GRI(JOFORMALE), MINIMIZIMI I KORRUPSIONIT DHE KONKURENCËS JO LOJALE SI PARAKUSHT I KONKURRUESHMËRISË SË SHËNDOSHË EKONOMIKE	15
5.1 OEMVP nënshkruese e deklaratës për partneritet dhe veprim “Përkushtim i përbashkët për formalizimin e ekonomisë joformale në RMV”	15
6. Marrëdhëniet me publikun	16
7. OEMVP në media	16
8. Komunikimi me anëtarët.....	17
9. OEMVP në rrjetet sociale	17
Shërbimet e OEMVP.....	18

Hyrje

Buletini i OEMVP është dokument i cili publikohet në baza kuartale dhe i cili përmban përshkrim të shkurtuar të aktiviteteve të OEMVP-së për periudhën e raportimit. Në kuartalin e parë gjegjësisht periudhën Janar – Mars 2026, OEMVP me qëllim të realizimit të vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike afatgjate të OEMVP-së ka organizuar aktivitete të ndryshme duke vazhduar të etablohet si një institucion i mirëfilltë dhe profesional i drejtuar në përkrahjen dhe avancimin e bizneseve në vend dhe më gjerë.

Strategjia e OEMVP-së për vitin 2024 – 2027 është e bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojat prioritare, aktivitetet e aktorëve tjerë si dhe mbi rolin e vet, dhe ka të definuara pesë objektiva strategjike. Bazuar në vizionin dhe misionin, po ashtu edhe në qëllimet afatgjate të Odës, gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar në arritjen e këtyre qëllimeve strategjike:

1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë.
2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin.
3. Shtet Evropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtritshme të energjisë.
4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste.
5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike.

Durim Zekiri
Drejtor Ekzekutiv

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

1. SUNDIM I LIGJIT, INSTITUCIONE EFEKTIVE ME PËRGJEGJËSI FISKALE DHE FINANCIARE SI NEVOJË THELBËSORE PËR EKONOMI TË FUQISHME TË TREGUT TË LIRË

1.1 Zhvillimi ekonomik dhe klima e biznesit në fokus të takimit mes OEMVP dhe zv. Kryeministrit të parë Bekim Sali

16.01.2026, Shkup – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore zhvilloi takim zyrtar me zv. Kryeministrin e parë të RMV, z. Bekim Sali, njëherit edhe Ministër për çështje evropiane. Qëllimi i vizitës ishte urimi i marrjes së funksionit të ri dhe diskutimi mbi mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm mes OEMVP dhe Qeverisë së RMV.



Gjatë takimit u diskutuan edhe çështje të rëndësishme për përmirësimin e ambientit biznesor, duke përfshirë nevojën për lobim të vazhdueshëm drejt krijimit të kushteve më të favorshme për bizneset, trajtimin e sfidave në dogana dhe procedurat e licencimit për iniciativat e ekonomisë së gjelbër.

1.2 Realizohet takim me Ministrin e Punëve të Brendshme të RMV. “Safe City” në fokus, OEMVP dorëzon kërkesa për mbrojtjen e aktivitetit afarist

21.01.2026, Shkup – Delegacioni i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore zhvilloi takim pune me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Pançe Toshkovski, ku u diskutua implementimi i sistemit “Safe City” dhe ndikimi i tij në ekonomi dhe aktivitetin afarist.



OEMVP, dorëzoi kërkesa dhe sugjerime konkrete lidhur me përmirësimin e sistemit, veçanërisht sa i përket punës dhe aktivitetit afarist të automjeteve të kompanive në komunikacion. Ministri Toshkovski u shpreh se këto propozime do të shqyrtohen me seriozitet dhe se do të gjenden zgjidhje për eliminimin e çdo paqartësie që mund të paraqitet gjatë zbatimit të sistemit.

1.3 Kryesia e OEMVP realizon takim me drejtoreshën e DAP. Në diskutim çështje me rëndësi për anëtarësinë e Odës

27.02.2026, Shkup - U.d. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z.Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv z. Durim Zeqiri, anëtarët e Këshillit Drejtues z. Sami Morina dhe z. Agron Mustafa, si dhe menaxherja operative Miranda Ajdini , zhvilluan takim me Drejtoreshën e Drejtorisë të të Ardhurave Publike, znj. Elena Petrova.

Gjatë takimit u ngritën shqetësime konkrete që lidhen me funksionimin praktik të proceseve tatimore. U diskutua për problemet teknike dhe mungesën e efikasitetit në sistemin e dorëzimit të llogarisë përfundimtare, të cilat po vështirësojnë respektimin e afateve ligjore nga kompanitë. Një ndër çështjet kryesore ishte edhe vonesa në kthimin e mjeteve nga TVSH-së, që po ndikon drejtpërdrejt në likuiditetin e bizneseve.



1.4 OEMVP realizon takim me Kryetarin e Kuvendit të RMV-së. Diskutimi u fokusua në Propozimin për ndryshimin e Ligjit për përmbarim

02.03.2026, Shkup – Kryesia e OEMVP, e përbërë nga U.D. Kryetari Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv Durim Zeqiri, Kryetari i Nderit Xhemail Dauti dhe Menaxherja Operative Miranda Ajdini, zhvilloi takim me Kryetarin e Kuvendit të RMV-së, Afrim Gashi, për të diskutuar mbi ndryshimet e propozuara në Ligjin për Përmbarim, me theks të veçantë tek neni 218, i cili aktualisht është i përfshirë edhe në ENER.

Gjatë diskutimit u theksua nevoja për eliminimin e elementit të favorizimit të ndërmarrjeve publike dhe për vendosjen e mekanizmave të llogaridhënies, në mënyrë që procesi i përmbarimit të jetë më i drejtë dhe transparent për të gjithë aktorët ekonomikë.



Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

1.5 OEMVP propozon ndryshime në Ligjin për Përmbarrim, në fokus mbrojtja e biznesit, transparenca dhe llogaridhënia

19.03.2026, Shkup - Kryesia e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore realizoi takim me Ministrin e Drejtësisë, Igor Filkov, në të cilin u diskutuan ndryshimet e propozuara në Ligjin për Përmbarrimin, me fokus të veçantë në Nenin 218.

Në takim morën pjesë u.d. Kryetari Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv Durim Zeqiri, Kryetari i Nderit Xhemail Dauti dhe Menaxherja Operative Miranda Ajdini.

Qëllimi kryesor i takimit ishte shqyrtimi i draft-ndryshimeve të publikuara në ENER, të cilat parashohin zgjerimin e mbrojtjes së fondeve dhe pasurive të institucioneve shtetërore, njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike nga procedurat e përmbarrimit.

OEMVP tashmë prej shumë vitesh me radhë ka alarmuar për problematikën që Neni 218 shkakton në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike, duke krijuar pasiguri juridike dhe vështirësi në realizimin e kërkesave të kompanive.



Informatori ligjor Juris dhe Juris Alarm

Gjatë kësaj periudhe OEMVP publikoi Informatorin ligjor JURIS dhe JURIS Alarm. Temat që u publikuan në këto informatorë ligjorë ishin:

- **JURIS Alarm nr.1** - Vendim për përcaktimin e kuotës së lejeve për të huaj që mund të angazhohen në punë në territorin e Republikës së Maqedonisë së veriut për vitin 2026;
- **JURIS nr. 1** - Dorëzimi i llogarive vjetore përfundimtare.

2. FUQI PUNËTORE TË MJAFTUESHME DHE TË KUALIFIKUAR ME NJË EKONOMI DIVERZE DHE ZHVILLIMORE QË PARANDALON EMIGRIMIN

2.1 OEMVP në takim me Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup. Diskutime mbi fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar

03.02.2026, Shkup - U.D. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, u mirëpritën në takim nga Rektori i Universitetit "Nënë Tereza", Prof. Dr. Bekim Fetaji.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, u diskutua për ngritjen e mekanizmave të përbashkëta të bashkëpunimit, përmes të cilave OEMVP do të përfshihet në procesin e hartimit të programeve të reja mësimore në të gjitha fakultetet e Universitetit "Nënë Tereza".



OEMVP theksoi kontributin e saj në zhvillimin e arsimit dhe shpreh gatishmërinë për të qenë një partner aktiv në bashkëpunimin me Universitetin, duke ofruar ekspertizë dhe mbështetje praktike për realizimin e projekteve të përbashkëta që lidhin arsimin me nevojat e tregut të punës.

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

3. SHTET EVROPIAN, ANËTARE E BE-SË, ME INSTITUCIONE DHE BIZNESE MODERNE TË DIGJITALIZUARA DHE TË DREJTUARA DREJT EKONOMISË CIRKULARE DHE BURIMEVE TË RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË

3.1 U realizua punëtori në OEMVP për pagesat në euro përmes SEPA

09.02.2026, Shkup - Në Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u organizua punëtori nga Banka Popullore, me qëllim që kompanitë anëtare të Odës të njoftohen nga afër me mundësitë dhe përfitimet nga kryerja e pagesave në Zonën e vetme të pagesave në euro SEPA.



Prezantimin e mbajtën drejtori i Sektorit për operacione në tregjet financiare dhe sistemet e pagesave, z. Igor Veliçkovski, dhe drejtoresha e Drejtorisë për sistemet e pagesave, znj. Biljana Donovska Geçeva.

Pjesëmarrës ishin kompanitë anëtare të Odës nga sektorët e tregtisë me shumicë dhe pakicë, shpërndarjes së produkteve, energjetikës, financave, sektorit farmaceutik, zyrave avokatore, spedicionit, ndërtimtarisë, si dhe veprimtarive shërbyese.

3.2 Kryesia e OEMVP realizon takim me Ministrin e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Diskutim mbi politikat mjedisore

16.01.2026, Shkup – Kryesia e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore realizoi takim zyrtar me Ministrin e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, z. Muhamed Hoxha. Qëllimi i takimit ishte urimi i z. Hoxha me rastin e marrjes së detyrës së re si Ministër, si dhe diskutimi i mundësive për bashkëpunim institucional ndërmjet OEMVP dhe Ministrisë.



U.D. Kryetar i OEMVP, z. Nuhi Aliu, theksoi rëndësinë e përfshirjes aktive të komunitetit të biznesit në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, duke vënë në pah nevojën për dialog të rregullt ndërinstytucional. Ai potencoi se OEMVP shërben si urë lidhëse mes Ministrisë dhe sektorit privat, veçanërisht në çështje që lidhen me tranzicionin e gjelbër, zbatimin e standardeve mjedisore, lehtësimin e procedurave administrative dhe promovimin e investimeve të qëndrueshme.

3.3 OEMVP merr pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes për skemën e granteve për bizneset e gjelbra- Tranzicioni i gjelbër, prioritet për zhvillimin e kompanive

05.02.2026, Shkup - Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Durim Zeqiri, së bashku me anëtarët e Këshillit Drejtues, morën pjesë në ngjarjen solemne të organizuar nga Agjencioni INOVA, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për projektin “Skema e granteve për mbështetjen e ndërmarrjeve për biznes të gjelbër” (Greening Business Facility – GBF).



OEMVP e përshëndet këtë iniciativë të Qeverisë, të mbështetur nga Bashkimi Evropian, e cila paraqet një mundësi konkrete për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të investojnë në teknologji të gjelbra, efikasitet energjetik dhe procese të qëndrueshme prodhimi. Kjo skemë grantesh është plotësisht në linjë me angazhimin e Odës për transformimin e gjelbër të sektorit privat.

3.4 Kryesia dhe anëtarësia e OEMVP pjesëmarrëse në ngjarje për mbështetjen dhe fuqizimin e ndërmarrjeve sociale

06.02.2026, Shkup – U.D. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore z. Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, morën pjesë në ngjarjen e organizuar nga Agjencia për Inovacion, Zhvillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Ndërmarrësi – INOVA, me temë “Promovimi i ndërmarrjeve sociale dhe ngjarja e donatorëve”.



Në fjalën përshëndetëse drejtuar të pranishmëve, U.D. Kryetar i OEMVP, theksoi rëndësinë e mbështetjes së sipërmarrjes sociale si një element kyç për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e mundësive të reja për përfshirje sociale, duke nënvizuar rolin e institucioneve dhe komunitetit të biznesit në nxitjen dhe avancimin e këtyre iniciativave.

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

Informatori ekonomik ECONOMICUS

Gjatë kuartalit të parë të vitit 2026 janë publikuar 3 edicione të informatorit ekonomik ECONOMICUS. Temat të cilat janë prezantuar në këtë informator ekonomik janë:

- **Economicus nr.1** – Indekset e çmimeve në bujqësi, dhjetor 2025;
- **Economicus nr.2** – Shkëmbimi tregtar me shtetet e jashtme, janar - dhjetor 2025 / 2024, të dhëna paraprake;
- **Economicus nr.3** - Indeksi i qarkullimit në industri, janar 2026.

Biznes Informatori DOBIA

Gjatë kuartalit të parë të vitit 2026 anëtarët e OEMVP kanë patur mundësi të njoftohen nëpërmjet biznes informatorit DOBIA për thirrje publike në lidhje me grante dhe mundësi për financim. Gjatë kësaj periudhe përmes e-mailit është dërguar tek anëtarët 1 edicion i informatorit, ndërsa njoftimi për dërgimin e të njëjtit është shpërndarë edhe në rrjetet sociale të Odës.

Thirrja e cilat është mbuluar në këtë edicion të informatorit është:

- **Dobia nr.1** – Thirrje publike nga Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet në Punë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, edhe këtë vit organizon Përzgjedhjen për ndarjen e Çmimit Kombëtar për kompaninë me sistemin më të mirë të implementuar për siguri dhe shëndet në punë.

4. ODË ME KREDIBILITET DHE PËRFSHIRJE LOKALE DHE RAJONALE, LIDERE NË MBROJTJE TË INTERESAVE AFARISTE

4.1 OEMVP zhvillon takim zyrtar me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme për bashkëpunim në funksion të rritjes ekonomike


14.01.2026, Shkup – Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, u zhvillua takimi me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme, z. Timço Mucunski, i cili u mirëprit nga U.D. Kryetari i OEMVP, z. Nuhi Aliu, Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, Nënkryetari, z. Jeton Asani, Kryetari i Kuvendit, z. Nazmi Ejupi dhe Kryetari i Nderit, z. Xhemal Dauti.



Qëllimi i takimit ishte forcimi i bashkëpunimit dhe promovimi i iniciativave të përbashkëta për zhvillimin ekonomik, si dhe identifikimin e mundësive për promovimin e bizneseve vendore në tregjet ndërkombëtare.

4.2 Drejtori ekzekutiv i OEMVP, Durim Zeqiri panelist në prezantimin e Strategjisë për NVM-të 2025-2030

14.01.2026, Shkup - Drejtori Ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zekiri, mori pjesë në panelin e diskutimit të organizuar në kuadër të projektit “BE për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, i financuar nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e prezantimit të Strategjisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2025–2030.



Gjatë diskutimit, z. Zekiri theksoi se: “Tranzicioni i gjelbër aktualisht perceptohet më shumë si kosto sesa si mundësi, sepse ekonomia jonë ka kapacitete të ulëta inovative dhe financiare për ta shndërruar atë në avantazh konkurrues”

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

4.3 OEMVP priti në takim Ambasadorin e Zvicrës në RMV, z. Kristof Zomer. U diskutua thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve

30.01.2026, Shkup - Kryesia e lartë e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore zhvilloi takim zyrtar me Ambasadorin e Konfederatës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Kristof Zomer.

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, me fokus të veçantë në nxitjen e shkëmbimit tregtar, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe investimeve të reja.



Pikë kyçe e bisedimeve ishte roli i diasporës së Maqedonisë së Veriut në Zvicër si urë lidhëse për bashkëpunim ekonomik, si dhe proceseve të digjitalizimit dhe shkëmbimit të know-how nga kompanitë zvicerane drejt bizneseve vendore.

4.4 OEMVP realizon mbledhjen e IV-të të Këshillit Mbikëqyrës. Diskutohen raportet dhe çështje mbi funksionimin e Odës

11.02.2026, Shkup - në hapësirat e OEMVP-së, u mbajt mbledhja e IV-të e Këshillit Mbikëqyrës, e udhëhequr nga Kryetari i saj, z. Fatmir Etemi, ku të pranishëm ishin anëtarët e KM, drejtori ekzekutiv z. Durim Zeqiri dhe menaxherja operative Miranda Ajdini.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan raportet e vitit 2025, me theks të veçantë në qëndrueshmërinë financiare dhe funksionimin e përgjithshëm të Odës. Po ashtu, u trajtuan edhe çështje të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen dhe përbushjen e përgjegjësisë të Këshillit Mbikëqyrës.



4.5 OEMVP nderohet me Mirënjohje për kontributin 15 vjeçar nga Fondacioni Albiz

12.02.2026, Shkup – Udhëheqësia e OEMVP, në krye me U.D kryetarin z. Aliu, drejtorin ekzekutiv z. Durim Zeqiri, anëtarë të KD dhe kompani anëtare ishin pjesëmarrës në ngjarjen solemne të organizuar nga Fondacioni Albiz, me rastin e 15-vjetorit të themelimit të tij dhe promovimit të Gjeneratës së XV-të të bursistëve. Ky përvjetor përfaqëson një moment të rëndësishëm reflektimi mbi rrugëtimin dhe kontributin e fondacionit në mbështetjen e të rinjve të talentuar ndër vite.



Gjatë ngjarjes, OEMVP u vlerësua me mirënjohje për kontributin, bashkëpunimin dhe përkrahjen e dhënë gjatë 15 viteve të veprimit të Fondacionit.

4.6 OEMVP bashkon institucionet dhe biznesin në Sofrën Tradicionale të Iftarit, në frymën e partneritetit dhe unitetit shoqëror

03.03.2026, Shkup – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore organizoi Iftarin Tradicional në ambientet e kompanisë anëtare Nita Palace. Ngjarja mbledhi përfaqësues të biznesit, krerët më të lartë të shtetit, përfaqësues të institucioneve, partnerë dhe media, duke ofruar një mbrëmje të veçantë ku u theksua vlera e bashkëveprimit dhe e mirëkuptimit.



Me praninë e tyre, ngjarjen e nderuan edhe Kryetari Kuvendit z. Afrim Gashi dhe Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Hristijan Mickoski.

U.d. kryetari i OEMVP-së, Nuhi Aliu, në fjalën e tij falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së vlerave të solidaritetit, respektit dhe bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve. Ai potencoi se ky organizim tradicional shërben si një urë lidhëse që forcon besimin, dialogun dhe partneritetin në shoqëri.

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

4.7 OEMVP realizon mbledhjen e I-rë të Këshillit Drejtues për vitin 2026

10.03.2026, Shkup – Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u realizua mbledhja e I-rë e Këshillit Drejtues për vitin 2026, ku u theksuan aktivitetet dhe nismat e realizuara nga OEMVP gjatë vitit të kaluar, të cilat kanë kontribuar në avancimin e interesave të sektorit privat dhe në forcimin e rolit të Odës si një zë i rëndësishëm.

Gjatë mbledhjes u prezantua raporti narrativ dhe financiar për vitin 2025, si dhe u diskutua dinamika e punës për periudhën në vijim, duke përfshirë aktivitetet që do të organizohen në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të OEMVP.



4.8 OEMVP pjesë e forumit ndërkombëtar për promovimin e investimeve në Budapest

30–31 mars 2026, Budapest – U.D. Kryetari i OEMVP-së, Nuhi Aliu, mori pjesë në ngjarjen promovuese ndërkombëtare të organizuar në kuadër të projektit “Promovimi i Hartës për Investime”, e dedikuar për komunitetin e biznesit dhe me fokus në thellimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Hungarisë.

Në këtë ngjarje morën pjesë edhe kompani anëtare të OEMVP-së, përfshirë Neting Institute, BIS OIL, Qendra Rea dhe Magna Group, si dhe përfaqësues të lartë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, duke dëshmuar angazhimin aktiv të sektorit privat dhe mbështetjen institucionale në promovimin e mundësive investuese dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë aktivitetit, u prezantua Harta e Investimeve e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u elaboruan në detaje mundësitë investuese, përfitimet për investitorët, sektorët kyç të zhvillimit, si dhe avantazhet konkurruese që ofron vendi.

Ngjarja përfshiu gjithashtu takime B2B ndërmjet kompanive nga të dy vendet, duke krijuar hapësirë për ndërtimin e partneriteteve të reja dhe konkretizimin e bashkëpunimeve të ardhshme biznesore.

Ky bashkëpunim reflektohet edhe në nivelin e shkëmbimit tregtar ndërmjet dy vendeve. Shkëmbimi tregtar me Hungarinë në vitin 2025 arriti në 576.9 milion euro, nga të cilat 363,2 milion eksport, ndërsaq import prej 213.7 milion euro.



5. ZVOGËLIMI I EKONOMISË GRI(JOFORMALE), MINIMIZIMI I KORRUPSIONIT DHE KONKURENCËS JO LOJALE SI PARAKUSHT I KONKURRUESHMËRISË SË SHËNDOSHË EKONOMIKE

5.1 OEMVP nënshkruese e deklaratës për partneritet dhe veprim “Përkushtim i përbashkët për formalizimin e ekonomisë joformale në RMV”

18.02.2026, Shkup - U.D. Kryetari i OEMVP-së, z. Nuhi Aliu, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, morën pjesë në Konferencën Vjetore të organizuar nga Ministria e Financave e RMV, me temë “Formalizimi i ekonomisë joformale: Përmes bashkëpunimit drejt suksesit”



Ky aktivitet mblodhi përfaqësuesit më të lartë të Qeverisë, odave ekonomike, organizatave të punëdhënësve, sindikatave, si dhe përfaqësues të komunitetit akademik, me synimin për të adresuar sfidat që lidhen me ekonominë joformale dhe për të diskutuar zgjidhje konkrete për rritjen e transparencës dhe konkurrencës së drejtë në treg.

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

6. Marrëdhëniet me publikun

22.01.2026 - U.D. Kryetar i OEMVP, z. Nuhi Aliu, i ftuar në emisionin "Biznes Plus" në RTM 2

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02eiCX9ZG5xhcqeNhDBEDKaXhfyTqtVrCkxwzFiomDH6qWBeVgnjW2xhG5HL2PcorNI>

29.01.2026 - U.D. Kryetari i OEMVP, z. Nuhi Aliu, i ftuar në TV ALSAT M

<https://www.facebook.com/reel/2639320909779645>

09.02.2026 – Drejtori i OEMVP, z. Durim Zeqiri deklarati për alfa.mk

<https://alfa.mk/25-milioni-evra-investiczi-za-modernizaczi%D1%98a-i-zeleni-investiczi-vo-stopanstvoto/>

19.02.2026 – Durim Zeqiri, Paga minimale-Biznes Plus

[Durim Zeqiri, Paga minimale- Biznes Plus 19.02.2026](https://www.youtube.com/watch?v=Hwo_YFu5R_U)

18.03.2026 - Rritja e çmimeve të naftës, flasin Nuhi Aliu, Abil Baush dhe Nefail Emini - Biznes Plus

https://www.youtube.com/watch?v=Hwo_YFu5R_U

Field Code Changed

7. OEMVP në media

Gjatë periudhës Janar – Mars 2026, përfaqësues të OEMVP kanë qenë prezent në media 7 herë, ndër të cilat:

- në emisione – 4;
- deklarata në TV – 3;

Gjithashtu, gjatë periudhës së njëjtë OEMVP është cituar mbi 20 herë.

8. Komunikimi me anëtarët

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 Desku i shërbimeve ka realizuar mbi 530 kontakte me kompani në forma të ndryshme (thirrje telefonike dhe e-mail) dhe njëkohësisht Desku i shërbimeve është kontaktuar rreth 500 herë.

Gjithashtu gjatë tremujorit të parë, në OEMVP janë anëtarësuar gjithsej 10 kompani të reja.


9. OEMVP në rrjetet sociale

OEMVP, me përfundimin e kuartalit të parë të vitit 2026, në rrjetin social FACEBOOK numëron gjithsej:

- 8,800 ndjekës;

Krahasuar me vitin paraprak, periudhën e njëjtë kemi rritje të ndjekësve për 3.1%.

Ndërkaq, OEMVP është aktive edhe në rrjetet tjera sociale dhe atë INSTAGRAM ku gjithsej numëron 619 ndjekës dhe LinkedIn me gjithsej 274 ndjekës.



Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.

Shërbimet e OEMVP

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore është një partner që ndihmon bizneset në rrugën e tyre drejt suksesit afarist përmes një game të gjerë shërbimesh.



SHËRBIMET INFORMATIVE – Anëtarët e OEMVP-së kanë mundësi të informohen nëpërmjet kanaleve të informimit në fushat e tyre të interesit siç janë: Informatori ekonomik **ECONOMICUS**, Biznes informatori **DOBIA**, Informatori Juridik **JURIS** dhe **JURIS ALARM**, **BULETINI I OEMVP-së**, **THIRRJE PËR TENDERË NDËRKOMBËTARË**, **PANAIRE RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE**.



SHËRBIMET PROMOVUESE – OEMVP nëpërmjet shërbimeve promovuese të saj, mbështet anëtarët e saj duke i promovuar të njëjtit, duke përfshirë këtu, kompanitë start-up, kompanitë të cilat kanë lancuar shërbim të ri, kompanitë që kanë oferta të reja promovuese, etj. Roli i odës është ti promovojë të njëjtit përmes: promovimit në **Rrjetet sociale**, shërbimit **“Anëtari për Anëtarin” (nëpërmjet e-mailit)**, **Logo në web faqen e OEMVP**, **video në korridorin e OEMVP**, **materiale promovuese në sallën e takimeve të odës si dhe katalogu TOP 100™**.



QENDRA E TRAJNIMEVE- Qendra e trajnimeve të OEMVP-së është aktive për të ju shërbyer kompanive me trajnime të temave të ndryshme, duke përbushur nevojat e tyre për trajnim dhe përgatitje të kuadrove të tyre. Trajnimet kryhen në bazë të **Planit vjetor të OEMVP-së** apo sipas **kërkesave specifike të anëtarëve**.



QENDRA PËR CILËSI DHE STANDARDE - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore përmes Qendrës së saj për cilësi dhe standarde, anëtarëve Ju ofron: **ISO Standarde**, **HASSP Standarde**, **Halal Standarde**.



KONSULENCA DHE ANALIZA – Ky shërbim përfshin: **Konsultime (ligjore dhe ekonomike)**, **Analiza financiare sipas kërkesës**, **Shërbime patentimi**, **Shërbime të pronësisë intelektuale**, **Kërkesa drejtuar institucioneve**.



SHËRBIMET E TJERA - Çertifikata e Origjinës, Çertifikata e Origjinës-Elektronike, Lobim, Lobim sipas kërkesave individuale, Ftesë për panairë virtuale për ndërlidhje të bizneseve me regjionin, Shërbime administrative, B2B takime, Qasje deri te Grupacionet e Odës, Ftesë në ngjarjet e OEMVP-së (seminare, konferenca, samite), Vende të rezervuara në çdo ngjarje të OEMVP-së, Asistim për pjesëmarrje në panairë të ndryshme botërore, Përfaqësim i interesave të anëtarësisë para institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, Drekë me kryeministrin/presidentin/ministrat, Iftari Tradicional, Vërtetim për anëtarësi.



SHËRBIME TEKNIKE – Hapësira të lira për anëtarët në zyrat e OEMVP-së për takime dhe biseda biznesore (deri 1 orë), Sallë për shfrytëzim njëditor dhe disaditor (deri 15 vende).



KATALOGU TOP 100™ - Katalogu TOP 100™ i kompanive më të suksesshme në Maqedoninë e Veriut është një platformë rrjetëzimi dhe promovimi, ku promovohen bizneset e suksesshme, por gjithashtu krijohen mundësi të reja për bashkëpunime potenciale mes anëtarëve ekzistues dhe anëtarëve potencial. Ky katalog ofron një mundësi të shkëlqyeshme, për kompanitë që duan të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre para një audience të gjerë, duke stimuluar vizibilitetin e tyre dhe forcimin e pozicionit në treg, dhe njëkohësisht duke i bërë kompanitë më konkurruese në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Vlerat dhe principet e OEMVP-së

Transparenca, Partneriteti, Qëndrueshmëria, Qasja e barabartë.